



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.500/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve K. Rr., Z. Th., S. K., N.e Rr., A. Sh., M. Sh. dhe A. Sh. nga fshati, Komuna e P., të cilët i përfaqëson me autorizim avokati A. H. nga P., kundër të paditurit H.Sh. K. nga P., të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme avokatja Emira Gavazaj Gashi nga P., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas revizionit të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3659/2021 datë 19.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurit H. Sh. K. nga P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3659/2021 datë 19.07.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3659/2021 datë 19.07.2024, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e të paditurit, ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.421/18 i datës 15.02.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, është aprovuar në tërësi kërkesëpadija e paditësve, si e bazuar dhe vërtetohet se ata në pjesë të barabarta janë pronar të ngastrës kadastrale nr. P-..., ZK- A., në sipërfaqe prej 965 m2, e cila gjendet tek vendi i quajtur “ Qelopek –Rupe” dhe detyrohet i padituri, ta pranojë këtë dhe të lejojë regjistrimin në librat kadastral, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimin të aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, masa e sigurimit e caktuar nga ana e gjykatës, me aktvendimin C.nr.421/18 dt.11.04.2018, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit ose deri në marrjen e vendimit tjetër nga gjykata, dhe me pjesën e III të dispozitivit, obligohet i padituri që paditësve tu kompensojë shpenzimet e procedurës

dhe atë në shumë prej 509-euro, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor pala e paditur ka paraqitur revizion për shkak të, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, që të aprovohet revizioni si i bazuar, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët ose të aprovohet revizioni si i bazuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, si dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i të paditurit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit më datën 26.03.2018, në gjykatën e shkallës së parë, kanë ngritur padi kundër të paditurit, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me të cilën kanë kërkuar që mbi bazën e parashkrimit fitues, të vërtetohet se janë pronarë të paluajtshmërisë të përshkruar si në petitudin e padisë dhe precizimin e saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Nga leximi i Certifikatës së vdekjes për të ndjerin Sh. Sh., e lëshuar nga Komuna e Prizrenit, me numër rendor ..., dt.24.02.2017, konstatohet se i njëjti ka ndërruar jetë më datën 2.06.2000, në fshatin ..., të Komunës së P.. Nga leximi i aktvdekjes në emër të Sh. Sh., lëshuar nga Komuna e P.t, më dt.1.12.2017, konstatohet se i njëjti ka lënë trashëgimtarët e tij dhe atë këtu paditësit. Nga leximi i Certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale ..., ZK-A., gjykata ka konstatuar se ngastra e cila është objekt i këtij kontesti evidentohet si ngastër me nr.P-..., ZK- A., ka një sipërfaqe prej 965 m2, gjendet në fshatin A., në vendin e quajtur “Qelopek – Rupa” dhe është e evidentuar në emër të R. A. K.. Nga leximi i petitionit të nënshkruar nga disa qytetarë të ..., është konstatuar se sipas këtij peticioni toka apo livadhi i cili gjendet në fshatin ..., “Te ...”, është e punuar (shfrytëzuar) nga H. Sh. Sh. dhe trashëgimtarët e tij, në afat kohor sa e mbajnë mend ata që e kanë nënshkruar të njëjtin prej kur kanë lindur dhe i njëjti është nënshkruar nga 14 qytetarë të fshatit A.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit A., i datës 6.10.2017, del se ara, livadhi, e cila gjendet në fshatin ..., në vendin e sipër përshkruar, është blerë nga Sh. Sh. (i ndjerë)

para afërsisht 50 viteve. E njëjta është shfrytëzuar dhe punuar pa asnjë pengesë, pa ndërprerë dhe pa asnjë trazim e shqetësim nga askush gjatë gjithë kësaj kohe. Një kohë është punuar nga Sherifi, sa ishte gjallë, kurse tani punohet dhe shfrytëzohet nga trashëgimtarët e tij.

Nga leximi i Certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastarle ..., – ZK- A., konstatohet se kjo ngastër evidentohet me nr. P-..., në sipërfaqe prej 795 m2, gjendet në fshatin ..., në vendin e quajtur “Qelopek- Rypa” dhe evidentohet në emër të Sh.A. Sh.. Nga leximi i Certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale ..., ka konstatuar se ngastra e cila është objekt i këtij kontesti, evidentohet me nr. P-..., ZK- A., ka një sipërfaqe prej 965 m2, e cila gjendet në fshatin ..., e evidentuar në emër të R. K.. Nga leximi i Certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale ..., të dt.7.03.2019, ka konstatuar se ngastra e cila është objekt i këtij kontesti evidentohet me nr. P-..., ZK- A., ka një sipërfaqe prej 965 m2, gjendet në fshatin A., në vendin e quajtur “Qelopek – Rupa” dhe se tash evidentohet në emër të H. Sh. K. apo këtu të paditurit.

Nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë të përpiluar nga K. G., dt.20.05.2020, konstatohet se ngastra kadastrale nr..., në vendin e quajtur “Qelopek – Rupa”, me kulturë shtëpi, me sipërfaqe prej 49 m2, dhe oborr në sipërfaqe prej 500 m2, dhe arë e klasit 4 në sipërfaqe prej 416 m2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 965 m2, evidentohet në fletën poseduese nr.23 ZK- A., ishte e evidentuar në emër të R. K. nga ..., dhe se me aktvendimin e trashëgimisë të Noterit në P., me numër LRP.nr....., Ref.nr....., dt.24.12.2018, ngastra kontestuese si e tërë kalon në emër të H. Sh. K., me të dhënat tjera si në ekspertizë.

Nga dëgjimi i dëshmitarëve, S. G., A. G., J. G., I. Sh.a, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paluajtshmërinë kontestuese i ndjeri Sh. Sh. (paraardhësi i paditësve) e ka blerë nga personi me emër R. K., (gjyshi i të paditurit) dhe atë para rreth 50, respektivisht, para 60 viteve, dhe blerësi Sh. Sh., nga atëherë ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të kësaj paluajtshmërie, ndërsa, pas vdekjes së tij, të njëjtën edhe sot e kësaj dite e shfrytëzojnë pasardhësit e tij, këtu paditësit, ndërsa, në anën tjetër, as vet shitësi R., e askush prej familjarëve të tij nuk e kanë punuar këtë tokë, që nga shitja e saj (rreth viteve 60-ta) dhe se pas shitjes së paluajtshmërisë, i njëjti ishte zhvendosur në

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve, është e bazuar, nga se të njëjtit, kanë provuar

se paluajtshmërinë kontestuese e kanë në posedim dhe shfrytëzim të papenguar nga askush, me mirëbesim, më shumë se 50 vite,(nga vitet e 60-ta), ndaj, në bazë të dispozitave nenit 28.4, nenit 30 etj, të LMTHPJ-së, ka vendosur si në pjesën I, II, dhe III, të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se e njëjta, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje të së drejtës materiale. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave të LPK-së dhe shkelje të së drejtës materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve pasi që janë dhënë arsye ligjore bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Kështu sepse, siç rezulton nga provat e zhvilluara dhe të administruara, dëgjimi i palëve ndërgjyqësore, leximi i certifikatave pronësore, ekspertiza e gjeodezisë, dëgjimi i dëshmitarëve dhe shkresave të tjera të lëndës, të sipër përmendura, paditësit kanë qenë në posedim me mirëbesim dhe të papenguar nga të tjerët në paluajtshmërinë kontestuese, (të cilën e kishte blerë paraardhësi i tyre, Sh.Sh., nga paraardhësi i të paditurit, R. K., tani të ndjerë), më shumë se 50 vite (nga vitet e 60-ta) dhe se të njëjtit, në bazë të parashkrimit fitues (usucapio) - mbajtjes kanë fituar të drejtën e pronësisë.

Kështu me dispozitën e nenit 28.4 të Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore juridike (që ishte në fuqi në kohën kur ishte krijuar raporti juridiko-civil konkret), parashihet se ” Poseduesi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm në të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë në atë send me mbajtje me kalimin e 20 viteve ”. Ndërsa, me dispozitën e nenit 20, të

këtij ligji, veç tjerash, parashihet se “ E drejta e pronësisë fitohet në bazë të vet ligjit, në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi “, kurse, me nenin 21 të këtij ligji, parashihet se me ligj fitohet e drejta e pronësisë, veç tjerash, edhe me parashkrim fitues, (me mbajtje) etj, siç edhe është vërtetuar në rastin konkret civil - juridik.

Pra, sikundër rezulton nga shkresat e lëndës, kjo Gjykatë konsideron se paditësit e kanë fituar pronësinë në paluajtshmërinë e më lartë theksuar, në bazë të ligjit përkatësisht në bazë të institutit të së drejtës civile - parashkrimit fitues – mbajtjes (usucapio), pra, në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 20, respektivisht nenit 28.4 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike. Po ashtu, në kontekstin e mësipërm, me dispozitën e nenit 30.2 të njëjtit Ligj, parashihet se ” Në kohën e nevojshme për parashkrimin fitues llogaritet edhe koha në të cilën pararendësit e poseduesit të tanishëm e kanë mbajtur (poseduar) sendin si posedues me mirëbesim dhe ligjor, përkatësisht, si posedues me mirëbesim ”, sikundër është edhe rasti konkret juridik civil, i përshkruar më lart.

Nga këtu dhe për arsyet e sipër përmendura, revizioni i të paditurit u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.500/2024 datë 6.11.2024

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha